



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë

Tel/Fax 04 2226814 ; 2226814

Nr. 260/4 Prot.

Tiranë, më 17. 05.2016

V E N D I M

Nr. 57, datë 17.05.2016

Mbi përfundimin e procedimit administrativ, për verifikimin e ligjshmërisë së zhvillimit të ecurisë disiplinore ndaj punonjësit të Njësisë Administrative Kashar, ***.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; neneve 80-104, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e informacionit protokolluar pranë Komisionerit me nr. 260 prot., datë 07.03.2016, mbi zbatimin e ligjit gjatë procedimit disiplinor,

VËREJ:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka mbërritur informacioni, që është protokolluar me nr. 260 prot., datë 07.03.2016, në të cilin është ngritur pretendimi për shkelje të kryera në procedurë e në përmbajtje, nga Komisioni Disiplinor i Bashkisë Tiranë, gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore dhe marrjes së masës "Lirim nga shërbimi civil" ndaj punonjësit *****. Nisur nga ky pretendim, Komisioneri vendosi kryerjen e verifikimit paraprak të këtij informacioni dhe vetëm nëse do të konstatoheshin dyshime të arsyeshme për shkelje të ligjshmërisë në zhvillimin e ecurisë disiplinore dhe nxjerrjen e Vendimit nr. 3444, dt.03.02.2016, të Komisionit Disiplinor pranë Bashkisë Tiranë, "Për marrje mase disiplinore", dalë në përfundim të saj, të fillonte procedimi administrativ përkatës.

Gjatë procesit të verifikimit paraprak rezultoi se, ndaj punonjësit ***** , me detyrë "Specialist në Zyrën e Shërbimeve Publike", në Njësinë Administrative Kashar, është zhvilluar një ecuri disiplinore për thyerje të rëndë të disiplinës në punë (mosparaqitje në detyrë, pa shkaqe të arsyeshme, për më shumë se 7 ditë), në përfundim të së cilës Komisioni Disiplinor i Bashkisë Tiranë, me Vendimin nr. 3444, dt. 03.02.2016, "Për marrje mase disiplinore", ka vendosur largimin e tij nga detyra.

Ndërkohë, nëpërmjet informacionit nr.260/3 prot., datë 24.03.2016, Komisioneri ka rënë në dijeni të faktit se ndërkohë, ankuesi *****, i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt:

“Shfuqizim të aktit administrativ Vendim, “Për marrje mase disiplinore”, të Komisionit Disiplinor të Bashkisë Tiranë, nr. 3444, datë 03.02.2016

-Kthimin e paditësit në pozicionin e punës “Specialist në Zyrën e Shërbimeve Publike, Njësia Administrative Kashar”, ose të ngjashëm me të.

-Detyrimin e të paditurit për pagimin e pagës nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies financiare, deri në kthimin në vendin e punës..”, e cila ka filluar trajtimin e kësaj padie.

Në këto kushte, referuar parimit të sanksionuar në nenin 36, të ligjit nr. 8116, dt. 29.3.1996 *“Kodi i Procedurës Civile”* i ndryshuar, sipas të cilit, institucionet e tjera nuk mund të trajtojnë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, si dhe nenit 41, pika 3, të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ku përcaktohet e drejta e nëpunësit civil për t’u ankuar në gjykatën kompetente për mosmarrëveshjet administrative, ndaj çdo veprimi apo mosveprimi që cënon të drejtat dhe interesat e tij të ligjshme në marrëdhënien e shërbimit civil, vlerësoj se, përsa kohë për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshje është vënë në lëvizje sistemi gjyqësor, nuk është i nevojshëm investimi i mëtejshëm apo ndërhyrja nga ana e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe në nenet 16 dhe 34, të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Përfundimin e procedimit administrativ për verifikimin paraprak të informacionit të ardhur pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nëpërmjet shkresës protokolluar me nr. 260 prot., datë 07.03.2016, për zhvillimin e ecurisë disiplinore dhe marrjen e masës disiplinore *“Largim nga detyra”* të nëpunësit *****, ish punonjës i Njesisë Administrative Kashar, Bashkia Tiranë.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Njësia e Burimeve Njerëzore pranë Bashkisë Tiranë dhe nëpunësi *****.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA